



**AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË
ARSIMIN E LARTË**

**Raporti i Akreditimit Periodik Institucional
i Universitetit Metropolitan të Tiranës**

Nëntor 2022

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM:

- Prof Florim Grajcevci Kryetar
- Dr Gjergj Thomai Anëtar

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi	Error! Bookmark not defined.
Përmbledhje e raportit	Error! Bookmark not defined.
Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimet e mëparshme	Error! Bookmark not defined.
Përmbledhje e gjetjeve	Error! Bookmark not defined.
Gjykime përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi	Error! Bookmark not defined.
Gjykim përmbledhës	Error! Bookmark not defined.
Raport i detajuar	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	Error! Bookmark not defined.
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	Error! Bookmark not defined.
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	Error! Bookmark not defined.
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi	Error! Bookmark not defined.
not defined.	
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	Error! Bookmark not defined.
Gjetjet	Error! Bookmark not defined.
Lista e dokumenteve	Error! Bookmark not defined.
Lista 1	Error! Bookmark not defined.
Dokumentet në gjuhën angleze:	Error! Bookmark not defined.
Dokumentet në gjuhën shqipe	Error! Bookmark not defined.
Lista 2	Error! Bookmark not defined.
Takimet e kryera gjatë vizitës	Error! Bookmark not defined.

Rreth këtij vlerësimi

Qëllimi kryesor i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë mase institucionet e arsimit të lartë (IAL-të) përmbushin Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që hynë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga Grupi i ekspertëve të Vlerësimit të Jashtëm, që përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve ndërkombëtarë dhe shqiptarë, të caktuar nga ASCAL-i.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga Universiteti Metropolitan i Tiranës, por edhe për t'u ofruar palëve të interesuara, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të i përmbushin këto standarde. Ky raport i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet që kanë nevojë për përmirësim (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe mënyrave për mbështetjen e të nxëniet të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve në zhvillim e sipër dhe pikat e dobëta për çdo Fushë Vlerësimi, duke përfshirë gjykimin se në çfarë niveli IAL-ja i përmbush standardet. Format e gjykimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Bordit të Akreditimit të ASCAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, ASCAL -i i ka ofruar Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mbështetje të specializuar, duke u siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe duke korrigjuar dhe përmbledhur raportin e plotë për përmbledhjen që vijon.

Përmbledhje e raportit

Universiteti “Metropolitan i Tiranës” (UMT) është licencuar me vendimin nr.357, datë 12.05.2010 të Këshillit të Ministrave me statusin e Shkollës Private të Arsimit të Lartë “Universiteti Metropolitan i Tiranës”. Universiteti Metropolitan i Tiranës (UMT) u krijua në vitin 2011 si IAL private si një iniciativë e sipërmarrjes së lirë, bazuar në filozofinë e arsimit cilësor, me standarde bashkëkohore dhe me synimin e qartë për të kontribuar në arsimin e lartë universitar të brezit të ri për rritjen e prosperitetit, mirëqenies dhe zhvillimit të vendit.

Ky është Vlerësimi i dytë Institucional i UMT-së për të vlerësuar shkallën e përmbushjes së Standardeve Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, të cilat hynë në fuqi në vitin 2011. Raporti i vlerësimit të parë (si Shkollë e Arsimit të Lartë) i kryer në dhjetor të vitit 2017 përfshin tre praktika të mira, dy dobësi, dy rekomandime dhe pohim të veprimeve që po ndërmerren për UMT-në. Për secilën fushë vlerësimi raporti përfshinte gjykimet e mëposhtme:

- Standardet për Organizimin dhe Menaxhmentin e tij janë përmbushur **plotësisht**.
- Standardet për Burimet janë përmbushur **kryesisht**.
- Standardet për Kurrikulën janë përmbushur **plotësisht**.
- Standardet për Mësimdhënie, mësimnxënie, Vlerësim dhe Kërkim janë përmbushur **plotësisht**.
- Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur **plotësisht**.

Në Dhjetor 2017, ekspertët e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm i rekomanduan Bordit të Akreditimit që UMT-ja i përmbushte **plotësisht** Standardet Shtetërore të Cilësisë dhe për pasojë, Bordi i dha UMT-së akreditimin për një periudhë pesëvjeçare.

Universiteti Metropolitan i Tiranës përbëhet nga Fakultetet e mëposhtme: Fakulteti i Ekonomisë (FE), Fakulteti i Inxhinierisë dhe Arkitekturës (FIA) dhe Fakulteti i Shkencave Kompjuterike dhe TI (FShKTI). Në këto fakultete ofrohen studime të nivelit të parë “Bachelor”, të nivelit të dytë “Master i shkencave dhe master profesional” dhe të nivelit të tretë “Doktoraturë”.

IAL ofron gjithsej 29 programe studimi dhe 2 programe të përditësuara të formimit profesional. Disa nga programet zhvillohen në gjuhën angleze. FE ofron gjithsej 10 programe studimi (1-profesional, 4 Bachelor, 3 Master Shkencor dhe Master Profesional). FIA ofron 5 programe studimi (2-profesionale, 1 Bachelor, 1 Master Shkencor i Integruar 5, 1 Master Shkencor.). FShKTI ofron 14 programe studimi (2-Profesionale, 5 Bachelor, 6 Master Shkencor, 1 Doktoraturë – Inteligjencë Artificiale dhe Sistemi Inteligjent i licencuar së fundmi).

Të gjitha programet janë me kohë të plotë. Në programin Bachelor dhe Master studiojnë 1186, shumica prej të cilëve janë me shtetësi shqiptare dhe një numër i vogël vijnë nga Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia. Deri më sot janë diplomuar 1409 studentë. Institucioni ka 67 anëtarë të personelit akademik me kohë të plotë, 117 me kohë të pjesshme dhe 32 anëtarë të personelit administrativ.

Universiteti Metropolitan i Tiranës ka hartuar raportin e vetëvlerësimit, të përgatitur nga Grupi i Vetëvlerësimit. Grupi përbëhet nga përfaqësues të drejtuesve të lartë, të personelit akademik

dhe administrativ dhe gjithashtu një student. Draftet e RVV-së u shpërndanë në nivele të ndryshme të Universitetit që të bëheshin komentet përkatëse dhe versiojini përfundimtar u përmbyll dhe u miratua nga Rektori dhe Senati.

Në RVV-it përfshihej një hyrje për funksionimin e Universitetit. RVV-ja u mbështet me dokumente, ndërkohë që dokumentet e synuara u vunë në dispozicion para dhe gjatë vlerësimit. Dokumentet u ofruan në gjuhën angleze dhe shqipë. Në përgjithësi, për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm RVV-ja ishte një dokument i dobishëm mbi të cilin mund të bazohej dhe vlerësimi.

Vizita u krye gjatë dy ditëve, më 12 dhe 13 shtator 2022. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga një anëtar i arsimit të lartë me përvojë nga institucioni i arsimit të lartë të Kosovës dhe një vlerësues i lartë i arsimit të lartë nga Shqipëria. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL).

Gjatë dy ditëve të vizitës së vlerësimit u organizuan një sërë takimesh, që i mundësuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të kuptojë më qartë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e personelit dhe të studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u takua me rektorin, personelin e lartë, studentët, personelin akademik, personelin administrativ dhe mbështetës, alumni dhe përfaqësues të organizatave lokale dhe partnere. Gjatë të gjitha takimeve u mbajtën shënime. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, si pjesë të vizitës në Universitet, vizitoi bibliotekën, sallat e kompjuterave, laboratorët, auditorët, zonat administrative dhe të gjitha objektet e tjera të UMT-së. Pas vlerësimit të të gjitha dokumenteve të vëna në dispozicion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti përfundimet e renditura më poshtë.

Institucioni i **përbush plotësisht** standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vuri në dukje tre praktika të mira; Zbatimin e reformës së zhvillimit dhe kërkimit nga senati akademik dhe Bordi i Administrimit, me qëllim promovimin e aktiviteteve kërkimore dhe motivimin e personelit akademik për t'u angazhuar në aktivitete kërkimore; Bashkëpunimin ndërkombëtar me institucione të ndryshme për hapjen e programeve të reja të studimit në përputhje me kërkesat e tregut; Politikën favorizuese efektive për mobilitetin akademik dhe të studentëve në nivel ndërkombëtar (**Kapitulli III, Standardi III.2**). Nuk u identifikua asnjë dobësi, dhe nuk u dha asnjë rekomandim dhe pohim.

Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vëren një karakteristikë të praktikës së mirë: Sigurimi i laptopëve të rinj, në rastin e regjistrimit të studentëve të rinj, konsiderohet një praktikë e mirë e IAL-së në lidhje me studentët (**Kapitulli III, Standardi VII.1**). Nuk u identifikua asnjë dobësi, nuk u dha asnjë rekomandim dhe pohim.

Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, dobësi, nuk dha asnjë rekomandim apo nuk ndërmori asnjë veprime që po vihet në zbatim. Gjatë gjithë procesit të vlerësimit, UMT-ja vuri në dispozicion dokumente të mjaftueshme për të demonstruar përkushtimin e tij për zgjidhjen e çështjeve të diskutuara në raportin e përgatitur bazuar në vizitën e akreditimit në shtator 2022.

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë

karakteristikë të praktikës së mirë, nuk u identifikua asnjë dobësi apo nuk u dha asnjë rekomandim, por ripohoi një masë që po zbatohet: UMT-ja zbaton politika të qarta për ndërkombëtarizimin e programeve të studimit dhe ka ndërmarrë hapa konkretë për të bashkëpunuar me institucionet partnere brenda dhe jashtë vendit për ofrimin e tyre. Institucioni ofron 4 programe studimi në gjuhën angleze dhe disa module në programet e tjera të studimit.

Standardet për Studentët dhe Mbështetja e tyre janë **përbushur plotësisht**. Në arritjen e këtij gjykimi, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë karakteristikë të praktikës së mirë, pikë të dobët apo veprime konfirmuese që po zbatoheshin, por dha një rekomandim: Faqja e internetit në gjuhën angleze përmban informacione të mjaftueshme, por duhet të pasurohet në mënyrë që të rritet interesi për regjistrimin ose mobilitetin e studentëve të huaj nga universitete të tjera në UMT.

Plotësimi i rekomandimeve nga akreditimi i mëparshëm

- *Institucioni duhet të rishikojë stokun e librave në bibliotekë, për të siguruar përmbushjen e nevojave të studentëve dhe personelit.*

Universiteti Metropolitan i Tiranës u riorganizua në vitin 2018 për të krijuar buxhetin për tre vite, për të rritur numrin e librave dhe literaturën online. [Referimi 01] IAL do të vazhdojë të rrisë kapacitetin e literaturës së librave dhe t'u ofrojë studentëve dhe personalit akademik platformat e bibliotekës elektronike. Ky është një proces i vazhdueshëm për rritjen e përhershme të cilësisë. Ndërkohë, u konfirmua se universiteti po ndërton kampusin e ri në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, i cili do të jetë një kampus modern me më shumë ambiente dhe hapësira. Sipërfaqja e kampusit do të jetë 20`000 metra katrorë. Rekomandimi është përmbushur plotësisht.

- *Institucioni duhet të marrë masa për të siguruar aksesin e personave me aftësi të kufizuara.*

Universiteti Metropolitan i Tiranës përdor dy godina të veçanta për shërbimet akademike dhe administrative. Ndërtesa kryesore është e pajisur me dy ashensorë vertikalë, që mund të përdoren nga personat me aftësi të kufizuara fizike. Në ndërtesën e dytë ekzistuese, ku gjenden kryesisht mjediset e laboratorëve, ka edhe një ashensor me hapësirë të madhe për personat me aftësi të kufizuara. IAL është pajisur me lejen e ndërtimit për Kampusin e ri Universitar, i cili do të ndërtohet në një sipërfaqe prej rreth 20.000 m2. Projekti i ri Arkitekturor i aksesit dhe zonave duhet të sigurojë të gjitha platformat e nevojshme hidraulike, ashensorët, etj. për përdorim komod. [Ref. 01; Ref. 88] U konfirmua se nuk ka asnjë student apo personel me aftësi të kufizuara motorike. Rekomandimi është përmbushur plotësisht.

- *Institucioni duhet të rrisë më tej mbështetjen për ndërkombëtarizimin e veprimtarisë së personelit të tij, veçanërisht të atyre të kualifikuar jashtë vendit.*

Universiteti Metropolitan i Tiranës jep këtë rekomandim për strategjinë e zhvillimit të universitetit. U zbatuan shumë mekanizma në funksion të këtij qëllimi. Zhvillimi i programit Erasmus (i gjithë personeli akademik i universitetit ka qenë të paktën një herë në një shkëmbim Erasmus), Financimi i udhëtimeve të shkëmbimit në universitetet jashtë vendit për personelin akademik. Institucioni mbulon shpenzimet e akomodimit dhe udhëtimit të personeli që lëviz jashtë vendit i ofrohen shpenzimet e akomodimit dhe udhëtimit. Personelit të ri i ofrohet mundësia që të kryejnë studimet e doktoraturës në bashkëpunim me Universitetet Franceze dhe Ambasadën e Francës. Rekomandimi është përmbushur plotësisht.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Zbatimi i reformës për Zhvillim dhe Kërkim nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, me qëllim promovimin e aktiviteteve kërkimore dhe motivimin e personelit akademik për t'u angazhuar në veprimtari kërkimore. (**Kapitulli III Standardi II.1**).
- Bashkëpunimi me Institucionet e Arsimit të Lartë kombëtar dhe ndërkombëtar për kryerjen e studimeve të doktoratës në përputhje me nevojat e tregut të punës. (**Kapitulli III Standardi III.2**).
- Politika favorizuese shumë efektive për mobilitetin e ndërsjellë të personelit akademik dhe studentëve në nivel ndërkombëtar. (**Kapitulli III Standardi III.4**).
- Sigurimi i laptopëve të rinj në rastin e regjistrimit të studentëve të rinj. (**Kapitulli III Standardi VII.1**).
- Lidhja e procesit mësimor me praktikën dhe praktikatat e gjata me pagesë që ofrohen nga partnerët. (**Kapitulli I Standardi II.1**).

Pikat e dobëta

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Faqja e internetit në gjuhën angleze përmban informacione të mjaftueshme, por duhet të pasqyrohet në mënyrë që të rritet niveli i interesit për regjistrimin e studentëve të huaj ose mobilitetin nga universitetet e tjera drejt UMT-së.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- UMT-ja zbaton politika të qarta për ndërkombëtarizimin e programeve të studimit dhe ka ndërmarrë hapa konkretë për të bashkëpunuar me institucionet partnere brenda dhe jashtë vendit për ofrimin e këtyre programeve. Institucioni ofron 4 programe studimi në gjuhën angleze dhe disa module për programet e tjera të studimit. (**Kapitulli II Standardi I.3**)

Gjykimet përmbledhëse për çdo Fushë Vlerësimi

- Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht**.
- Standardet për Burimet janë **përbushur plotësisht**.
- Standardet për Kurrikulën janë **përbushur plotësisht**.

- Standardet për Mësimdhënien, të Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë **përbushur plotësisht.**
- Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë **përbushur plotësisht.**

Gjykim i përmbledhur

Grupi i Vlerësuesve të Jashtëm i rekomandon Bordit të Akreditimit që Universiteti Metropolitan i Tiranës i përbush plotësisht Standardet Shtetërore të Cilësisë.

Raport i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1. Universiteti Metropolitan i Tiranës e ushtron veprimtarinë e tij akademike dhe shkencore në përputhje me aktet ligjore në fuqi, në statutin e tij dhe në të gjitha aktet e tjera të miratuara nga organet dhe autoritetet drejtuese të UMT-së. Ai është institucion jopublik i arsimit të lartë dhe është themeluar në vitin 2010. [Ref. 05; Ref. 07] Organet drejtuese të UMT-së janë Rektorati, Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Asambleja e Pronarëve dhe Këshilli i Etikës [Ref. 06; Ref. 10]. Në Statut përcaktohen parimet bazë, misioni, vizioni, strukturat e brendshme organizative dhe drejtuese. Gjithashtu, në statutin e IAL-së parashikohet autonomia e UMT-së për përzgjedhjen e lirë akademike, financiare, organizative dhe të personelit dhe ky dokument është në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë. [Ref. 12]. Bazuar në zhvillimin e tij nga viti në vit dhe në përputhje me kërkesat ligjore të aplikuara në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për statusin “Universitet”, vendimi i miratuar nga Bordi i Lartë Drejtues në janar të viti 2017, bëri që institucioni të merrte statutin e Universitet, nga një Shkollë Private e Arsimit të Lartë. [Ref. 13] UMT-ja, në përputhje me ligjin për rregullimin e Universiteteve të IAL-ve, ka zbatuar programet e studimit me tre nivele. Së fundmi, Senati dhe Bordi i Administrimit ka zbatuar reformën për Kërkim dhe Zhvillim [Ref. 31] me qëllim promovimin e veprimtarive kërkimore në institucion si dhe motivimin e stafit akademik dhe strukturave të tjera për t'u angazhuar në veprimtari kërkimore. Kësisoj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstaton se Universiteti dhe strukturat e tij e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me statutin. [Ref. 121; RVV fq.9] (*Kapitulli III, Standardi I.1*)
- 1.2. UMT-ja organizohet për të siguruar efektshmërinë e menaxhimit në përputhje me kërkesat legjislative, rregulloret dhe planin strategjik të Zhvillimit. Në fakt institucioni po harton planin strategjik për periudhën 2022-2027. [Ref. 26_EN; Ref. 25_AI]. Statuti përcakton misionin, organizimin e brendshëm dhe strukturat e menaxhimit. [Ref. 12]. Përgjegjësitë individuale dhe formale të bordit dhe këshillit përcaktohen gjithashtu në rregullore. [Ref. 18; Ref. 19; Ref. 20; Ref. 21, RVV f.11-12]. Studentët përfaqësohen në Senat përmes zgjedhjes së një përfaqësuesi studentor. [Ref. 18; Ref. 41] Në marrëveshjet për menaxhimin dhe administrimin e Institucionit dhe vendimmarrjen kolegjiale, merren parasysh pritshmëritë ligjore. Gjithashtu, ato funksionojnë siç duhet dhe respektojnë transparencën. [RVV p12; Ref. 13 Ref. 14] Çdo Fakultet i UMT-së ka Dekanin e tij i cili është në cilësinë e menaxherit të organeve kolegjiale si njësi kryesore akademike. Gjithashtu, këto të fundit menaxhojnë njësitë akademike bazë siç janë departamentet. Fakultetet e UMT-së kanë tri njësi akademike bazë – departamente që kanë stafin akademik dhe programet e studimit. [RVV. P11; Ref. 12; Ref. 13] Sipas organogramës së UMT-së të miratuar nga organet kolegjiale të IAL-së, menaxhimi i lartë i qeverisjes së UMT-së është Rektorati. Kompetencat e Rektoratit përcaktohen në statutin e IAL-së në përputhje me Ligjin për IAL-në. [RVV. P11; Ref. 12] Njësia më e vogël është departamenti i menaxhuar nga shefi i departamentit. Drejtuesi i Departamentit zgjidhet nga radhët e stafit të brendshëm akademik me gradën e doktoraturës. Gjatë vizitave të kryera në Institucion, u dhanë informacione të qarta lidhur me funksionimin e veçantë të secilit organ kolegjial, pa pasur asnjë ndërhyrje. Rektorati luan një rol të rëndësishëm në administrimin e aktiviteteve akademike, harton planin strategjik të zhvillimit dhe mbledh propozimet e palëve të interesuara të Universitetit. Rektorati përbëhet nga rektori dhe zëvendësrektorët, të cilët mbulojnë të gjitha drejtimet e veprimtarive të Universitetit. Rektori, dekanët dhe Drejtuesit e Departamenteve

zgjidhen për një mandat katër vjeçar, sipas kërkesave të ligjit. Studentët, personeli akademik dhe joakademik mund të marrin pjesë në zgjedhjet për autoritetet drejtuese të universitetit. Është e rëndësishme që studentët të përfaqësohen edhe në Senatin Akademik **[Ref. 18; Ref. 12]. (Kapitulli III, Standardi I.2)**

- 1.3. UMT-ja ka politika për mbështetje dhe inkurajon debatin në të gjitha organet kolegjiale **[Ref. 17]**. Organet drejtuese të UMT-së mbledhen rregullisht, në përputhje me dispozitat e rregulloreve specifike për funksionimin e tyre. **[RVV p14; M1; Ref.11_EN; Ref.30_AL; Ref.44_AL]** Senati, si organi më i lartë kolegjial akademik i Universitetit, e ushtron veprimtarinë e tij duke u mbledhur rregullisht. Vendimet e marra nga bordet për funksionimin e IAL-ve dhe diskutimet kolegjiale kuptohen nga personeli akademik dhe studentët. **[RVV p12; M 2,5,7]**. Dekanët, drejtuesit e departamenteve dhe drejtuesit përgjegjës të qendrës kërkimore kanë për detyrë të mbikëqyrin veprimtarinë kërkimore në nivel fakulteti. Organi kolegjial akademik - senati marrin vendime për nevojat akademike, kërkesat akademike që paraqiten nga departamentet miratohen nga dekanët. **[M9; Ref. 17] (Kapitulli III, Standardi I.3)**
- 1.4. Universiteti Metropolitan i Tiranës funksionon në përputhje me kuadrin ligjor për arsimin e lartë, në përputhje me të cilin ka hartuar aktet e tij të brendshme të funksionimit që garantojnë autonominë e jashtme dhe të brendshme të institucionit. Autonomia e brendshme sigurohet përmes Statutit dhe Rregullores së universitetit, të cilat parashikojnë rregullat organizative dhe funksionale të institucionit, si dhe vlerësimet periodike institucionale. **[Ref. 12; Ref 13; Ref. 14; Ref. 15; Ref. 20; Ref. 21, RVV. p13]**. Gjithashtu, nga takimet e zhvilluara rezultoi se IAL-ja është autonome për menaxhimin e financave që vijnë nga projektet dhe raportet kombëtare. Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë pranë UMT-së shërben për të lehtësuar qasjen në themelimin e Programeve Evropiane dhe përditësimin e atyre ekzistuese. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë luan një rol kyç në monitorimin dhe analizimin e efektivitetit të aktiviteteve të vlerësimit të brendshëm. **(Kapitulli III, Standardi I.4)**
- 1.5. UMT-ja ka një strategji të përshtatshme të zhvillimit në formën e *Draft Planit Strategjik 2022-2027* i cili duhet të miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. **[RVV p13&14; Ref. 26_EN; Ref 25_AI; M2]** Strategjia është hartuar në përputhje me misionin dhe objektivat e UMT-së dhe është marrë në konsideratë gjatë fazave të ndryshme të zhvillimit të saj nga organet drejtuese dhe këshillat. **[RVV pp12&13; M2]** Në Planin Strategjik përcaktohen aspektet kryesore të institucionit që kërkojnë zhvillim të mëtejshëm, si: mësimdhënia dhe studimi, ndërkombëtarizimi dhe mobiliteti, kërkimi, angazhimi social, personeli dhe infrastruktura. Dokumenti është shumë i qartë dhe mbulon planin e veprimit për arritjen e objektivave strategjike dhe të rezultateve të pritura **[Ref. 31]**. Universiteti ka hartuar plane specifike zhvillimi, politika kërkimore, menaxhimin e projekteve, hapjen e programeve të përbashkëta **[Ref. 25; Ref. 31]** Njësitë kryesore dhe bazë kanë hartuar dhe zbatuar plane veprimi për të përmbushur kërkesat e Strategjisë. **[RVV p12; M2] (Kapitulli III, Standardi I.5)**
- 1.6. Në përputhje me nenin 32 të ligjit nr.80/2015, për çdo vit akademik, të gjitha institucionet e arsimit të lartë dorëzojnë në ministrinë përkatëse raportet vjetore për veprimtarinë e tyre, gjendjen financiare, parashikimin e angazhimit të personelit akademik, tarifat shkollore për vitet në vijim. arsimi. **[Ref. 77]**. Raporti vjetor i dorëzuar në mënyrë periodike vlerëson efektivitetin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në njësitë kryesore të UMT-së në përputhje me standardet. Universiteti publikon në nivel institucional një raport vjetor që mbulon aktivitetet kryesore akademike, kërkimore dhe financiare, mësimdhënien, shërbimet etj. **[Ref. 32; Ref. 28; Ref. 77]**. Raporti vjetor institucional hartohet nga një grup pune i përbërë nga përfaqësues të strukturave të

ndryshme. Grupet e punës krijohen nga Rektorati. Raporti vjetor përgatitet në bazë të informacionit të dhënë në raportet vjetore të fakulteteve dhe strukturave individuale të Universitetit. Raporti diskutohet gjerësisht në një takim të hapur të Senatit Akademik me aktorë të ndryshëm. **[RVV, M9]**. Raporti i rënë dakord publikohet në faqen e internetit të Universitetit dhe një kopje i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Raporti përfundimtar miratohet nga Senati Akademik. **(Kapitulli III, Standardi I.6)**

- 1.7. Liria akademike është e sanksionuar në Statutin dhe Rregulloren e Universitetit. **[Ref. 12; RVV p14&15, M2]**. Autonomia dhe liria akademike ndihmojnë në përmbushjen e misionit dhe qëllimeve të institucionit. Liria akademike shprehet në lirinë e mësimdhënies, lirinë për hartimin ose rishikimin e kurrikulave, lirinë për hapjen ose mbylljen e programeve të studimit ose njërive përbërëse të tij, lirinë e kërkimit shkencor, lirinë e krijimit **[RVV p14, M7]**. Institucioni ka autonomi financiare, për të realizuar marrëveshje të pavarur me institucione të ndryshme dhe organizata përkatëse në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar **[Ref. 33]**. Universiteti ofron programe studimi për tre cikle dhe numri i studentëve është në përputhje me misionin, kapacitetet dhe synimet **[Ref. 11]**. UMT-ja ka lirinë për të kryer kërkime shkencore bazë dhe të aplikuara. Personeli akademik ka të drejtë të organizojë mësimdhënien, kërkimin shkencor, përmirësimin e kurrikulës, të marrë pjesë në konferenca dhe botime shkencore si pjesë e detyrimit të tyre akademik ose e përparimit në karrierën e individit **[Ref. 36 to 40; M7]**. Universiteti është i organizuar në 3 Fakultete, secili prej të cilëve përfshin të paktën tre departamente, me gjithsej 9 departamente **[Ref. 6]**, duke plotësuar kriteret dhe kërkesat ligjore për numrin efektiv dhe nivelin e kualifikimit shkencor të personelit mësimor **[Ref. 39]**. Universiteti dhe çdo njësi kryesore kanë një faqe interneti publike, e cila është e disponueshme për studentët, personelin akademik dhe publikun. Kjo faqe përditësohet vazhdimisht përmes sektorit dhe procedurës së saktë të komunikimit. Personeli akademik është i kualifikuar siç duhet dhe ushtron autonomi dhe liri akademike në mësimdhënie, kërkime dhe të gjitha aktivitetet e tjera akademike. Strukturat drejtuese, ekzekutive dhe administrative janë të ndara nga strukturat akademike dhe njësitë organizative. IAL-ja deklaroi zbatimin e reformës së ardhshme, me qëllim nxitjen e veprimtarisë kërkimore të personelit akademik dhe nxitjen e tyre duke ulur ngarkesën mësimore dhe duke rritur kërkimin. **[M2, M7](Kapitulli III Standardi II.1)**
- 1.8. Organet kolegjiale – Senati Akademik, Bordi i Administrimit, Rektorati, Këshilli i Etikës, Këshilli Studentor, IQAU – e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në bazë të statutit dhe rregulloreve të UMT-së **[Ref. 12; Ref. 13; Ref. 41]**, me procedura të qarta institucionale që lejojnë debatin konstruktiv dhe lirinë akademike **[Ref. 6; Ref. 12]** siç parashikohet me statut. Studentët konfirmojnë se kanë mundësi të ngrenë çështje, të angazhohen në debat dhe të informohen për punën e këtyre bordeve formale dhe vendimet e marra. **[M2, 3; Ref. 41; Ref. 18; Ref. 21; Ref. 12]**. Studentët mund të ngrenë çështje përmes Këshillit Studentor dhe përfaqësuesve të tyre të zgjedhur në Senat. Përfaqësuesit e të gjitha palëve të interesuara të Universitetit në organet kolegjiale janë të garantuara me statut **(Kapitulli III Standardi II.3)**
- 1.9. IAL-ja pretendon se është plotësisht e angazhuar në dinamikën e biznesit dhe e përdor atë informacion për të monitoruar përshtatshmërinë e kurrikulave të tij dhe për të inicuar programe të reja studimi. UMT-ja ka filluar të monitorojë punësimin e të diplomuarve të saj ndër vite, duke mbajtur kontakte me të sapodiplomuarit. Ata kanë filluar të krijojnë një bazë të dhënash në disa departamente për të kontrolluar mënyrën si kurrikulat e tyre përshtaten me tregun e punës. Ky proces mbikëqyret nga Zyra e Këshillimit për Karrierën dhe Alumni. Ka ende shumë punë për të bërë për përfundimin e kësaj baze të dhënash. Gjatë takimit me të diplomuarit ata u pyetën nëse universiteti ka mbledhur ndonjë të dhënë nga punësimi i tyre dhe përgjigje ishte pozitive. **[M8; M10]** Institucioni

informohet vazhdimisht për zhvillimin ekonomik rajonal nëpërmjet burimeve të ndryshme të informacionit, si dhe nëpërmjet bashkëpunimeve me institucione të tjera ose duke marrë pjesë në konferenca që trajtojnë problemet e zhvillimit [Ref. 42]. UMT-ja ka kryer një studim të tregut të punës, gjë e cila i ndihmon ata të vendosin prioritete për programet e reja të studimit ose riorganizimin e programeve ekzistuese të studimit. Zyra e Këshillimit të Karrierës monitoron punësimin e të diplomuarve [Ref. 102] dhe konfirmoi se ata janë punësuar përkatësisht në vende pune që i përshtaten diplomës së tyre. Programet e ofruara nga Institucioni publikohen në faqen e internetit dhe për këtë arsye janë të disponueshme edhe për publikun. [<https://MTU.edu.al/>][Ref. 27, M2] **(Kapitulli III Standardi III.1)**

- 1.10. Për sa i përket bashkëpunimit rajonal, prioritet i jepet bashkëpunimit me zonat shqipfolëse të Ballkanit Perëndimor. Kjo duket një qasje e arsyeshme, e cila mund të sjellë përfitime reciproke për të gjitha palët e përfshira. Programi i shkëmbimit Erasmus e ka lehtësuar këtë shkëmbim pasi siguron fonde të mjaftueshme si për studiuesit ashtu edhe për studentët [RVV,p.17; Ref. 50; Ref. 51]. Ndërkohë, në bashkëpunim me partnerë nga Mali i Zi, Serbia, etj, universiteti ka aplikuar për propozime projektesh të përbashkëta në formën e thirrjeve të hapura si Fondet e Ballkanit Perëndimor, Interreg, etj. Është e qartë se qëllimi i universitetit është të bashkëpunojë kryesisht me institucione që e kanë bazën në BE, në veçanti me Universitetet Franceze, pasi ato ofrojnë mbështetjen e nevojshme për arritjen e synimeve të AUF-së si për kërkimin dhe ndërkombëtarizimin. Në këtë drejtim, me mbështetjen e Ambasadës Franceze dhe AUF-së (Agjencia e Universiteteve Frankofone), UMT-ja po zbaton studimet e doktoraturës në bashkëpunim me Universitetet Franceze. [RVV,p.17; Ref. 110; Ref. 111; Ref. 112; Ref. 113]. Ngritjen e laboratorit të Inteligjencës Artificiale për zhvillimin e studimeve kërkimore për kandidatët e doktoraturës, në bashkëpunim me laboratorët francezë, Grupi i vlerësimit të Jashtëm e vlerëson si **praktikë të mirë** [Ref. 158; Ref. 159; Ref. 51; Ref. 48; Ref. 47]. **(Kapitulli III Standardi III.2).**
- 1.11. Për sa i përket bashkëpunimit me institucionet dhe partnerët e jashtëm kombëtar, grupi i vlerësimit të jashtëm vërejtë se UMT-ja është pozicionuar mirë, për faktin se shumë nga drejtuesit e institucioneve shtetërore me të cilët kanë më shumë gjasa të bashkëpunojnë, janë alumni të UMT-së. UMT-ja ka lidhur marrëveshje partneriteti me institucionet shtetërore dhe private për të ofruar shërbime për studentët dhe për të siguruar që programet e saj të studimit të përmirësohen dhe të përshtaten për të përmbushur nevojat dhe pritshmëritë e tyre. [Ref. 158; Ref. 159; Ref. 51; Ref. 48; Ref. 47]. **(Kapitulli III Standardi III.3).**
- 1.12. UMT-ja është aktive në aktivitete shkencore dhe mobilitete të stafit dhe studentëve përmes projekteve në nivel institucional [Ref. 47-53;165] ose në nivel individual. Grupi i vlerësimit të jashtëm u informua si nga stafi ashtu edhe nga studentët [M3,4,7] për pjesëmarrjen në projekte ose programe mobiliteti. Studentët informohen nëpërmjet burimeve të ndryshme për projektet dhe inkurajohen të marrin pjesë në konkurse ndërkombëtare, praktika në kompani të huaja, ose të ndjekin programe në institucione jashtë Shqipërisë, siç janë projektet e realizuara nga studentët në bashkëpunim me AUF-Agjencinë Universitare Frankofone. UMT-ja është e fokusuar të pranojë profesorë dhe studentë të huaj në programe studimore dhe shkencore bazuar në numrin e planifikuar të kuotave. Institucioni inkurajon mobilitetin dhe integrimin e studentëve të huaj dhe personelit akademik të ftuar [Ref. 163; Ref. 164]. Gruoi i vlerësimit të jashtëm arrin në përfundimin se Universiteti ka një politikë shumë efektive favorizuese për mobilitetin e ndërsjellë të personelit akademik dhe studentëve në nivel ndërkombëtar dhe e konsideron atë si praktikë të mirë. **(Kapitulli III, Standardi III.4)**

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Zbatimi i reformës për Zhvillimin dhe Kërkimin nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, me qëllim nxitjen e aktiviteteve kërkimore dhe motivimin e personelit akademik për t'u angazhuar në veprimtari kërkimore. **(Kapitulli III Standardi II.1).**
- Bashkëpunimi me Institucionet e Arsimit të Lartë kombëtar dhe ndërkombëtar për zhvillimin e studimeve të doktoratës në përputhje me nevojat e tregut të punës. **(Kapitulli III Standardi III.2).**
- Politika favorizuese shumë efektive për mobilitetin e ndërsjellë të personelit akademik dhe studentëve në nivel ndërkombëtar. **(Kapitulli III Standardi III.4).**

Pikat e dobëta

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi në këtë fushë vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk dha asnjë rekomandim në këtë fushë vlerësimi.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi asnjë pohim të veprimit të ndërmarrë në këtë fushë vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë **përbushur plotësisht.**

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1. Struktura akademike e UMT-së po përmirësohet në mënyrë dinamike dhe kapacitetet e burimeve njerëzore janë në rritje të vazhdueshme. Universiteti e ka bërë publike strukturën e tij organizative **[Ref. 6; Ref. 10]** në faqen e internetit të Universitetit. Procesi i rekrutimit të personelit akademik dhe administrativ me kohë të plotë dhe të pjesshme është i hapur, transparent, në përputhje me Legjislacionin, Statutin dhe Rregulloren **[Ref.12; Ref. 54-63]**. IAL-ja vepron në përputhje me politikën e punësimit, e cila i prezantohet personelit akademik me kontrata të rregullta me kohë të plotë, personelit akademik me kontratë me kohë të pjesshme dhe personelit të administratës. Kriteret për çdo vend të lirë pune propozohen dhe ndiqen nga procedura të qarta, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare të Universitetit. Procedurat e rekrutimit, duke përfshirë kriteret e njoftimit dhe vlerësimit janë në përputhje me Statutin. **[Ref. 12; Ref. 59]**. Procedurat e rekrutimit janë transparente, të qarta, të hapura duke përfshirë të drejtën

- për ankimim [Ref. 14; Ref. 59] dhe kandidatët fitues, qofshin personel akademik apo ndihmës, pajisen me një kontratë pune [Ref. 60; Ref. 63; Ref. 72-74]. Dekani mbledh komisionin me anëtarët e departamenti për procesin në vazhdim dhe vlerësimin e vendit të lirë të punës. Komisioni i përzgjedhur për vlerësim, në bazë të kriterëve të shpallura në konkursin për vendin e punës, vlerëson dhe i dorëzon një raport dekanit duke propozuar kandidatin me të cilit do të lidhet kontrata përkatëse. IAL promovon kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik, administrativ dhe ndihmës [Ref. 65; Ref. 66]. Grupi i vlerësimit të jashtëm arrin në përfundimin se UMT-ja ndjek një politikë të hapur të punësimit dhe rekrutimit të burimeve njerëzore. **(Kapitulli III Standardi IV.1).**
- 2.2. UMT-ja promovon bashkëpunimin me personelin asistent akademik dhe administrativ, nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në aktivitetet akademike, praktikën profesionale dhe punën laboratorike. Personeli mbështeti pikëpamjen në raportin e vetëvlerësimit se personeli akademik, krahas mësimdhënies, është i angazhuar në një sërë aktivitete, si seminare, ngjarje në terren dhe organizata sociale. Anëtarët e stafit të UMT-së kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në strukturat drejtuese, autoritetet dhe komisionet përmes një procesi të hapur, transparent dhe konkurrues [Ref. 40; Ref. 64-68]. Universiteti inkurajon pjesëmarrjen e personelit në aktivitete, projekte, trajnime të ndryshme duke i mbështetur edhe financiarisht [Ref. 64-68]. Për të ndihmuar integrimin e personelit të Universitetit, ata angazhohen në aktivitete të ndryshme, duke përfshirë pjesëmarrjen në javën orientuese si me personelin ashtu edhe me studentët, panairë, trajnime, seminare etj. [Ref. 67-69]. Gjatë vizitës, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konstatoi një bashkëpunim të kënaqshëm mes personelit akademik dhe administratës së IAL-së, duke i mbështetur studentët lidhur me çështjet e tyre. Gjatë takimit me personelin, Grupi i vlerësimit të jashtëm u informua edhe për një politikë të favorshme për integrimin e personelit në jetën shoqërore [M7]. **(Kapitulli III Standardi IV.2)**
